



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

NJOFTIM PËR SPECIALIST NE FUSHEN E PERPUNIM DRURIT “EKIPET SPORTIVE NE SHKOLLA”

“ SPECIALIST NE FUSHEN E ARKITEKTURE / DESIGN GRAFIK”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpikë Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit “Ekipet Sportive ne Shkolla”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për SPECIALIST NE FUSHEN E ARKITEKTURE / DESIGN GRAFIK pjesë të Projektit Ekipeve Sportive në Shkolla.

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpikë. Projekti do të formojë Ekipe sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar dhe në nivelin shkollë e mesme.

KOKSH, per nevojat e saj, mbështetur ne Ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik ” (i ndryshuar), neni 74 dhe 75, kerkon ekspertize nga specialist te jashtem ne fushen Arkitekt ose Grafik Dizajn, konkretisht:

- 1 (nje) specialist Arkitekt ose Dizajn grafik per ne Njesine e harimit te dokumenteve
- 1 (nje) specialist Arkitekt ose Dizajn grafik per ne komisionin e vleresimit te ofertave

Detyrat e Specialistit:

- Pjesemarje ne grupet e punes per hartim specifikime teknike dhe vleresim ofertash

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Te kene eksperience pune.
- Të jene te profilizuar ne fushen e arkitekture / design.

Kandidatet e interesuar mund te shprehin interesin e tyre brenda nje afati 1 javor nga dalje e ketij njoftimi ne email secretary.general@nocalbania.org.al ose prane zyrave te KOKSH.